REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:067366
Datë: 23.10.2020
Numri i dokumentit: 01213524

C.nr.926/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike të paditëses S.B. nga Ferizaj të cilën me autorizim e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, në çështjen juridike pagesa e pagës jubilare, në prezencën e të autorizuarit të paditëses, dhe në mungesën e të paditurës, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 21.tetor.2020 morri :

A K T GJ Y K I M

I.APROVOHET në tërësi, kërkesëpadia e paditëses S.B. nga Ferizaj, si e bazuar.

II.DETYROHET e paditura që paditëses S.B. nga Ferizaj, ti paguaj në emër të dy pagave jubilare shumën prej 1373.7€ në emër të 2(dy) pagave jubilare me kamatë ligjore prej 8%, që nga dita e paraqitjes së kësaj padie datë 11.06.2020 si dhe të ia kompensoj të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 269 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av Fadil Sinanaj , ka parashtruar padi kundër të paditurës lidhur me pagesën e shpërblimit jubilar për dy paga mujore dhe në seancën e dt.21.10.2020 i autorizuari e paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkese padisë si dhe provave të ofruara në padi dhe pas administrimit të provave i propozon gjykatës që kërkesë padinë ta aprovoj në tërësi të bazuar. Përgjigjen në padi e të paditurës e kundërshtoj në tërësi si të pa bazuar. Konsideron se është vërtetuar themelësia e kërkesë padisë andaj i propozon

2020:067367

gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar duke e detyruar të padituren që paditëses S.B. të ja kompenzoj shumën në vlerë prej 1373,70€ me kamate ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së saj deri në pagesën definitive të kësaj shume në emër të shpërblimeve jubilar. Gjithashtu i kërkon shpenzimet kontestimore dhe atë 30 euro për takse gjyqësore, 104 euro për përpilim të padisë, 135 euro për seancë gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm

I padituri në përgjigjen në padi të datës 30.09.2020 ka deklaruar se kërkesë padia e paditëses është e pa bazuar përkundër marrëveshjes kolektive SHSKUK-ja nuk ka ndarë fond të veçanta për pagesat jubilare, çka që spitali Ferizajt nuk ka mjete për pagesat jubilare sipas nenit 52 të MPK. Dhe si e tillë aktualisht është e pa realizuar nga ana e SP te Ferizajt.

Gjykata me datë 21.10.2020 ka caktuar seance ku në seance është paraqitur i autorizuari i paditëses, kurse nga fletkthesa rezulton se paditura e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt, nuk është prezantuar në seancë, mungesën nuk e ka arsyetuar si dhe nuk ka kërkuar shtyërjen e saj, dhe i autorizuari i paditëses ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të padituës meqë njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjykata këtë aktvendim (që ka të bëjë me mbajtjen e seancës pa praninë e të padituri) e ka bazuar në dispozitën e nenit 423 par.4, në të cilën përcaktohet se, nëse i padituri që është thirrur me rregull nuk vjen në seancën gjyqësore, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes mbahet pa praninë e tij,

Gjykata, për këtë çështje nuk ka caktuar seancë përgatitore, por drejtpërdrejt ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, edhe pse në parim seancë përgatitorë është e detyrueshme. Neni 401 i LPK-së-së, parasheh *''Seanca përgaditore është e detyrueshme, përveçse në rastet në të cilat gjykata.....nga shkaku i pandërlikueshmërisë së kontestit vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgaditore''*.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t`i parashtruar ato, në kuptim të nenit 8.1 të LPK-së, Gjykata ka administruar provat si vijojnë: padia Padita C.nr.926/20 e dt 11.06.2020,

2020:067367

Kontrate pune ne emër te paditëses e dt. 01.01.2013 Kërkesë Nr.12/19 të datës 01.04.2019, behet shqimi në listat e pagës, Përgjigja ne padi e datës 30.09.2020

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësja ka punuar tek e paditura, gjithashtu nuk është kontestuese se paditësja ka përvojën e punës mbi 20 vite përvojë pune.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë prej dy paga mujore në emër të shpërblimit jubilare në lartësi prej 1373.7€ e ka marrë për bazë vërtetimin mbi përvojën e punës e lëshuar nga e paditura, gjithashtu nga listat e pagave gjykata ka vërtetuar se paditësja tek e paditura ka pasur pagën neto 686.85 Euro.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Kontrata Kolektive sektoriale ne nenin 17,paragrafi 3 ,nenparagrafi3.3 për dy (dy) paga mujore ne emër te shpërblimit jubilar 2x686.85=1373.7€ pasi qe vlera e një page mujore e paditëses është 686.85 euro,: ***1. Palët në këtë kontratë, të gjitha kontestet ndërmjet tyre do ti zgjidhin përmes konsultimeve dhe dialogut të ndërsjellët. 2. Në rast se kontesti në mes palëve nuk mund të zgjidhet sipas paragrafit 1 të këtij neni, për zgjedhjen e kontestit palët drejtohen ne gjykatën kompetente. 3. Punëtorët shëndetësor të cilët janë anëtarë të sindikatës gëzojnë mbrojtje ligjore nga sindikata.***

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësja e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që e njëjta përfiton nga kjo kontratë për faktin se me rastin e daljes së tij në nga puna kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të padituës.

Në nenin 17 par. 3 pika 3.1, 3.2 3.3, të kontratës kolektive për të punësuarit në shëndetësi është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë të punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, te

2020:067367

shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 17 par.4, të ia paguajë tri paga jubilare pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 30 vjeçare dhe ka qenë obligim i të padituës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim të padituës, dhe me rastin e vendosjes është bazuar në këtë fakt se meqenëse nuk ka pasur ndryshime në pagat që të merret një mesatare e ka marr për bazë tri pagat e fundit që ka ndodh në rastin konkret rezulton se paditësja ka pasur pagën mujore tek e paditura 686.85 Euro €, ku për dy muajt e fundit kap shumën përgjithshme të këtyre pagave është 1373.7 Euro

Se paditësja S.B. ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës e datës 01.01.2013 dhe po ashtu ky fakt nuk ishte kontestues midis palëve ndërgjyqësore

Sa përket pretendimit të përfaqësuesit të padituës në përgjigje në padi se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësja, andaj gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të kompensimit të një page jubilare paditëses ia ka njohur të drejtën e kamatës nga dita e paraqitjes padisë deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së, andaj obligohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 269 € dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 104 €, për tri seanca të avokatit shumën prej 135 €, si dhe për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 30€.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

C.nr.926/20 datës 21 tetor 2020

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi- Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE**:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.